



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 07, datë 17.05.2019

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“AEROPORTI NDËRKOMBËTAR I KUKËSIT, BASHKIA KUKËS”

Në mbështetje të Neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Aeroporti Ndërkombëtar i Kukësit, Bashkia Kukës”, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare “Kukës International Airport” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

